

Konkurs fotografie "WORK4YOUTH"

Rreth 75 milionë të rinj në mbarë botën nuk kanë qënë në marrëdhënie pune në vitin 2012. Në ditët e sotme janë të papunë 4 milionë të rinj më shumë në krahasim me vitin 2007, ndërsa mbi 6 milionë kanë hequr dorë nga kërkimi i një vendi pune. Më shumë se 200 milionë të rinj që punojnë fitojnë më pak se 2 USD në ditë të ardhura. Gjithashtu vazhdon të jetë i shumëpërhapur punësimi informal i tyre.¹

Megjithë vështirësitë dhe ndërlikimet që paraqet kjo periudhë për të rinjtë ata vazhdojnë të jenë elastikë. Të rinjtë janë shumë të motivuar dhe ofrojnë ide dhe këndvështrime të reja. Ata janë nxitësit e zhvillimit ekonomik dhe humbja e këtij potenciali përbën një humbje ekonomike. Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi potencialin e të rinjve, Programi për Punësimin e të Rinjve të ILO-s, sponsorizuar nga Fondacioni MasterCard, dhe Zyra e ILO-s në Budapest organizojnë një **Konkurs Fotografie "WORK4YOUTH"**

Lexoni informacionin në vijim për të mësuar se si MUND TË FITONI këtë Konkurs Fotografie

Jeni i ri në fushën e fotografisë ose fotograf i afirmuar? Nuk ka problem! Ne duam të shohim fotografitë tuaja!

Kjo është mundësia JUAJ për të kapur sfidat me të cilat përballen gratë dhe burrat e rinj në kërkim të punës së denjë, si dhe elasticitetin dhe risitë e tyre në kapërcimin e sfidave.

Fotot tuaja duhet të paraqesin në mënyrë krijuese dhe origjinale **të rinjtë në vendin e punës** (vende dhe kushte të ndryshme pune) dhe të nxjerrin në pah **sfidat dhe elasticitetin në punësim**. Janë të mirëpritura ndër të tjera dhe çështjet që lidhen me tematika të tilla si: **kushtet e këqija të punës; barrierat gjinore; diskriminimin; informalitetin në ekonomi; sipërmarrjen; varfërinë e të punësuarve; migrimin; punën e pasigurtë; ekonominë rurale**. Vështroni rreth e rrotull!

Ndër aspektet e kërkuara të pasqyrohen janë:

- Momente interesante, formuese dhe shkollimi të punonjësve/punëkërkuesve të rinj;
- Momente të padallueshme dhe të fshehura që u ofrojnë njohuri punëtorëve të rinj/përvojat e punëkërkuesve në tregun e punës;
- Entuziazmi dhe energjia e paimitueshme dhe pashtershme e punëkërkuesve /punonjësve të rinj;
- Vizionet dhe pritshmëritë e të rinjve.

Ju lejohet të paraqisni deri në 5 fotografi. Afati i dorëzimit është deri në orën 12:00 në mesnatë (sipas orës të Evropës Qendrore) të datës **15 prill 2013**. Dorëzimet mbas kësaj date nuk do të merren në shqyrtim.

¹ ILO.2012.Kriza e punësimit të të rinjve:Ftesë për veprim (Gjenevë)

Për të marrë pjesë ju duhet të jeni mbi 18 vjeç dhe banor në një nga vendet e kualifikuara. Ju lutem shikoni vendet e kualifikuara në listën përkatëse në:

<http://www.ilo.org/public/english/standards/relm/country.htm>;

Fotografët e 2 fotografive më të mira do të fitojnë çmimet e mëposhtme:

- Fotografia më e mirë: Çmimi 1,000 USD
- Fotografia e dytë më e mirë: Çmimi 500 USD

Në kuadër të partneritetit me Programin për Punësimin e të Rinjve dhe Zyrën Vendore në Budapest, konkursi do të ketë një qasje specifike për rritjen e vizibilitetit mbi sfidat e punësimit të të rinjve dhe ftohen të aplikojnë konkurrentë që janë rezidentë të Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL). Për këtë arsye një çmim i posaçëm do të jepet për konkurrentë nga EQL.

Fotografi i fotografisë më të mirë nga EQL do të fitojë çmimin e mëposhtëm:

- Fotografia më e mirë nga EQL: Çmimi 1,000 USD

Me qëllim që të sigurohet pjesëmarrja e të rinjve në këtë konkurs fotografie, pjesëmarrësit e grupmoshës 18-29 vjeç do të marrin një çmim të veçantë për rininë.

Fotografët e rinj të fotografive më të mira do të fitojnë çmimet e mëposhtme:

- **Çmimi për rininë (për grupmoshën 18-29): Çmimi 800 USD**
- **Çmimi për rininë (për grupmoshën 18-29 nga EQL): Çmimi 800 USD**

Fituesit do të kontaktohen brenda 15 ditëve nga mbyllja e konkursit. ILO do të kontaktojë fituesit përmes e-mailit dhe do të kujdeset për dhënien e çmimeve.

Kushtet dhe konditat

- Një fotograf mund të paraqesë deri në 5 fotografi;
- Fotografët duhet të jenë autori i vetëm i fotografive të dorëzuara dhe të kenë të gjitha të drejtat nga pronësia intelektuale mbi to;
- Për të marrë pjesë në konkurs fotografët duhet të jenë mbi 18 vjeç dhe me banim në vendet e kualifikuara. Jeni të lutur të shihni listën e vendeve të kualifikuara në <http://www.ilo.org/public/english/standards/relm/country.htm>
- Për të marrë pjesë në konkurs duhet të plotësohet **Formulari Zyrtar i Pjesëmarrjes** dhe fotografitë të paraqiten përmes e-mailit në adresën ilophotocontest@gmail.com. duke deklaruar emrin e plotë, moshën, gjininë dhe shtetin;

- Fotografët duhet të kenë marrë leje me shkrim nga subjekti/et që paraqiten në fotografitë e tyre ku bien dakort për termat dhe kushtet e konkursit të fotografisë "WORK4YOUTH";
- Fotografitë dorëzohen shoqëruar me një titull, datën e shkrepjes së fotografisë, vendin dhe legjendën.
- Paraqitja e fotografive do të pranohet vetëm në format dixhital dhe ato nuk duhet të jenë të përmirësuara apo të manipuluar;
- Imazhi i fotografisë duhet të jetë 10 MB ose më i vogël, në format JPEG ose .jpg, dhe duhet të jetë të paktën 1.600 piksel i gjerë (në rast të një imazhi horizontal) ose 1,600 piksel i gjatë (në rast të një imazhi vertikal);
- Fotografitë që kanë fituar çmime në konkurse të tjera fotografie nuk do të merren në konsideratë;
- Fotografitë që janë publikuar nuk do të merren në konsideratë;
- Fotografitë duhet të dërgohen deri në orën 12:00 të mesnatës (me orën e Evropës Qendrore) të datës **15 prill 2013**;
- Punonjësit e ILO-s nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurs;
- Me pjesëmarrjen në konkursin e fotografisë fotografët bien dakort dhe pranojnë kushtet dhe termat e konkursit.

Çështje ligjore

• Pjesëmarrësit i japin Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), partnerëve të saj dhe agjencive të tjera të OKB-së, si dhe personave apo subjekteve të tjerë të autorizuar nga ILO, të drejtën falas, jo ekskluzive, të pakthyeshme, të transferueshme, të përhershme në mbarë botën, licencën për të përdorur të drejtën e autorit, të drejtat e lidhura me të dhe të drejtat e tjera apo çdo të drejtë tjetër pronësie intelektuale që rrjedh apo do të rrjedhë në të ardhmen nga ligji në lidhje me fotot e përgatitura dhe dorëzuara. ILO ka të drejtën, por jo detyrimin, të publikojë fotografitë. ILO nuk mban asnjë përgjegjësi për probleme teknike apo të tjera që mund të pengojnë dorëzimin e fotografive tuaja. Duke dërguar fotografinë tuaj, ju pranoni këto kushte dhe terma pjesëmarrjeje. ILO shprehimisht rezervon të drejtën për të përjashtuar fotografi nëse pjesëmarrësit shkelin termat dhe kushtet e pjesëmarrjes ose në rast të një arsyeje të ngjashme ose në rast dyshimi.

Si mund të paraqisni fotografitë tuaja

- Ju duhet të dërgoni fotografinë/të tuaja me e-mail në adresën xx@xxx,
- Kur të dërgoni fotografinë/të, JU DUHET të shënoni moshën tuaj dhe vendin e rezidencës në **Kutizën e Subjektit (Subject BOX)** të e-mailit. Fotografitë NUK do të pranohen nëse ky informacion nuk është pasqyruar në **Kutizën e Subjektit (Subject BOX)**;
- Ju duhet të plotësoni dhe dorëzoni Formularin Zyrtar të Pjesëmarrjes dhe të pranoni kushtet dhe termat e konkursit të fotografisë (shih më poshtë);

- Çdo fotografi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm: Titullin, datën e shkrepjes, vendin, legjendën (maksimumi 100 fjalë) që shpjegon çfarë paraqitet në fotografi.

Gjykimi

Një panel gjyqtarësh do të vlerësojë fotografitë bazuar në:

- Lidhjen me objektivin e konkursit;
- Kompozimin/ndriçimin e fotografisë;
- Originalitetin;
- Legjendën;

Ekspozita

- Fotografia fituese dhe fotografi të tjera të përzgjedhura do të shfaqen në një ekspozitë on-line në faqen zyrtare të ILO-s;
- Mbas vlerësimit, të gjithë fotografët puna e të cilëve është përzgjedhur për tu shfaqur në ekspozitën on-line do të njoftohen përkatësisht.

Një imazh mund të shprehë njëmijë fjalë. Bëhu i dukshëm! Le të jetë ky një konkurs i frytshëm!

FORMULARI ZYRTAR I PJESËMARRJES
Dorëzimi i fotografive për Konkursin e Fotografisë
WORK4YOUTH

Emri:

Datëlindja (dd/mm/vv):

Mosha:

Gjinia: ☐ Mashkull

☐ Femër

Vendi i rezidencës:

Kombësia:

Profesioni:

Numri i telefonit:

E-mail:

Numri i fotografive të paraqitura:

Detaje mbi fotografitë (deri në 5 fotografi):

Nr.	Emri i dosjes (file name)	Data e fotografisë	Vendndodhja	Titulli i fotografisë	Legjenda (Maksimumi 100 fjalë në anglisht që shpjegojnë se çfarë paraqet fotografia)
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

Jeni të lutur të plotësoni kutizat e mëposhtme:

- ☐ Kam lexuar marrëveshjen & dhe kushtet për të drejtat e autorit më poshtë dhe jam dakort me kushtet dhe termat e konkursit të fotografisë.
- ☐ Kam plotësuar dhe bashkëlidhur Formularin Zyrtar të Pjesëmarrjes për dorëzimin e fotografive.
- ☐ Gjatë dorëzimit të fotografive, do të paraqes moshën time dhe vendin e rezidencës në Kutizën e Subjektit (subject box) të e-mail.

Emri:

Data(DD/MM/VVVV)

**** Formulari Zyrtar i Pjesëmarrjes do të pranohet vetëm i shtypur ose i skanuar. Ju gjithashtu mund të paraqisni gjithë informacionin e përfshirë në formular me email kur të dorëzoni fotografitë. Ju bëjmë me dije se gjithë informacionet dhe marrëveshjet duhet të përfshihen në e-mail, në të kundërt dorëzimi i fotografive nuk do të merret në konsideratë.**

Marrëveshja & Të Drejtat e Autorit – Konkursi i Fotografisë WORK4YOUTH

Termet dhe Kushtet

Midis Organizatës Ndërkombëtare të Punës, përfaqësuar nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, e quajtur më poshtë "ILO" dhe pjesëmarrësit në Konkursin e Fotografisë WORK4YOUTH, i quajtur më poshtë "fotografi", së bashku "palët" është rënë dakort si më poshtë:

1. Fotografi do të ofrojë ILO-s mbështetje origjinale (dosje *(file)* numerike me rezolucion të lartë me një minimum prej 6 Mega piksel) dhe do të paraqesë për çdo fotografi titullin më të plotë të mundshëm.
2. Fotografi deklaron se fotografitë janë bërë nga ai/ajo vetë dhe garanton se ai / ajo zotëron të gjithë të drejtat e autorit mbi fotografitë e paraqitura përjashtuar çdo individ apo subjekt tjetër ligjor.
3. Fotografi i transferon ILO-s licencën e përhershme, të pakthyeshme, të lirë dhe plotësisht të nënlicensueshme për të përdorur, riprodhuar, përfaqësuar, transmetuar, përshtatur, modifikuar, publikuar, shpërndarë, fotografitë e paraqitura nga fotografi në përputhje me këtë marrëveshje, duke përfshirë të drejtën për të dhënë me nën-licencë palëve të tjera çdo të drejtë të përfshirë në licencë. Në rast se dhe sa herë ILO publikon fotografitë do të përpiqet të sigurojë që emri i fotografit të shfaqet në këtë mënyrë: ILO / emri i fotografit.
4. Fotografi deklaron se ka marrë leje me shkrim nga subjekti/tet e shfaqur në fotografi, ku shprehet miratimi dhe deklarata se fotografia do të dorëzohet në konkursin e fotografisë "WORK4YOUTH" dhe se është rënë dakort që imazhet mund të përdoren nga ILO sipas parashimeve të Marrëveshjes dhe Kushteve dhe Termave të Konkursit. Në rastet kur subjekti/tet e shfaqur në fotografi nuk kanë aftësinë për të dhënë pëlqimin e tyre, fotografi deklaron se pëlqimi është dhënë dhe është i vlefshëm, në përputhje me ligjet në fuqi - p.sh. dhënë nga përfaqësuesit ligjorë të autorizuar për këtë qëllim.
5. Fotografi duhet të veprojë në përputhje me kushtet dhe termet e tjerë të konkursit të fotografisë WORK4YOUTH.
6. Asgjë në këtë marrëveshje ose në lidhje me të nuk do të konsiderohet heqje dorë nga privilegjet dhe imunitetet e ILO-s.
7. Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur miqësisht me negociata të drejtpërdrejta informale çdo mosmarrëveshje midis tyre që rrjedh nga kjo Marrëveshjeje, në të kundërt çështja do të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit në përputhje me rregullat e UNCITRAL-it që janë në fuqi në datën e parashtrimit të kërkesës në arbitrazh. Nëse nuk është rënë dakort ndryshe, vendi i arbitrazhit do të jetë në Gjenevë, Zvicër, dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze. Tribunali i arbitrazhit do të përbëhet nga një arbitër i vetëm. Palët bien dakord se do të njohin çdo vendim arbitrazhi të dhënë në përputhje me këtë nen, si gjykimin përfundimtar të çdo mosmarrëveshjeje.

Të drejtat e autorit (Copyright)

- Duke marrë pjesë në këtë konkurs ju pranoni t'i jepni ILO-s licencën e përhershme, të pakthyeshme të lirë dhe plotësisht të nënlicensueshme për të përdorur, riprodhuar, përfaqësuar, të transmetuar, përshtatur, modifikuar, për të krijuar vepra derivative, për të publikuar, për të shpërndarë fotografitë e dorëzuara nga fotografi në përputhje me këtë marrëveshje, duke përfshirë të drejtën për të dhënë nën-licencë palëve të tjera në lidhje me çdo të drejtë të përfshirë në licencë;
- Pjesëmarrja përbën dhënie pëlqimi dhe miratimi nga ana e fotografit dhe çdo personi që shfaqet në fotografi për një licencë për ILO-n të plotë dhe të vazhdueshme për të përdorur, shfaqur, shpërndarë, riprodhuar dhe për të krijuar vepra derivateve nga fotografitë ose pjesë të fotografive të kombinuara ose jo me imazhe të tjera, tekste dhe grafika, të prera, të ndryshuara ose të modifikuara, në internet ose në çdo mjet tjetër të përshtatshëm për rritjen e ndërgjegjësimit, shkëmbimin e informacionit, raportimin, trajnimin dhe formimin, editoriale, reklama, marketing, qëllime promovuese ose për çfarëdo lloj qëllimi tjetër, pa asnjë kompensim për fotografimin;
- ILO rezervon të drejtën për të përdorur fotografitë në botime të tilla si revista, kalendarë, raporte, kartolina, ose në çdo formë tjetër të përshtatshme shtypi;
- Nëse dhe sa herë që ILO do të publikojë fotografitë do të përpiqet të sigurojë se emri i fotografit shfaqet si më poshtë: ILO / emri i fotografit;
- ILO mund të mbajë një bibliotekë të të gjithë fotografive të dorëzuara për këtë konkurs dhe mund ti vërë në dispozicion të çdo pale që dëshiron t'i përdorë fotografitë në mënyrë të miratuar nga ILO;

Fotografi, përfaqësuesit e emëruar në mënyrë të rregullt të palëve, kanë rënë dakord për termat dhe kushtet si dhe të drejtat e autorit me paraqitjen e **Formularit Zyrtar të Pjesëmarrjes**.